



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

BURSA STUDIMI NË ITALI VITI AKADEMIK 2019-2020

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar e Republikës së Italisë ofron bursa studimi në Itali për shtetas të huaj dhe për qytetarë italianë që jetojnë jashtë Italisë dhe që dëshirojnë të ndjekin studime në nivelin master, PhD, programe kërkimore, si dhe në kurse të gjuhës dhe kulturë italiane, në arte, muzikë, valle, etj., pranë universiteteve, institucioneve të njohura publike të Arsimit të Lartë Italian, për vitin akademik 2019-2020. Bursat e studimit të ofruara nga qeveria italiane synojnë nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar kulturor, shkencor dhe teknologjik, promovimin e gjuhës dhe kulturës italiane.

Aplikimet do të vlerësohen nga një Komitet i ngritur nga Misioni Diplomatik i akredituar në vendin e origjinës së aplikantit. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes, Misioni përkatës Diplomatik do të publikojë listën e individëve që kanë përfituar bursën. Masa e bursës mujore është 900 euro dhe paguhet në një nga bankat e Italisë. Bursa do të jepet duke filluar nga 1 janari 2020 dhe përfundon më 31 tetor 2020. Kësti i parë i bursës do të merret vetëm pas përfundimit të regjistrimit dhe dorëzimit të të gjitha dokumenteve sipas kriterëve të Universitetit përkatës. Kësti i fundit i bursës do të merret vetëm pas verifikimit të rezultateve akademike, të cilat duhet të jenë kënaqshme në përputhje me kriteret e vendosura nga pala italiane.

Formulari i regjistrimit gjendet ne faqen web: <https://studyinitaly.esteri.it/registrazione>.
Afati i fundit i aplikimit është data **30 Maj 2019**.

Për një informacion më të detajuar lidhur me mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, programeve të studimit, afateve përkatëse, si dhe kriterëve që lidhen me nivelin e njohjes së gjuhës së kërkuar dhe moshës së kandidatëve, etj., referojuni materialeve informuese bashkëlidhur dhe adresave në web-site:

<https://studyinitaly.esteri.it>

<https://studyinitaly.esteri.it/en/call-for-procedure>;

https://www.esteri.it/mae/resource/doc/2019/04/bando_a.a.2019-2020_in_italiano.pdf;

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS